




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës si dhe me rekomandim datës 13.11.2020 të Komisionit për shqyrtim të kërkesave për licencim të Qendrës Rinore "Naxhije dhe Fahri Buçinca" në Vushtri, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për Licencim të Qendrës Rinore në Vushtri

1. Me këtë vendim, Organizatës Joqeveritare "Hareja" në Vushtri i ipet licenca për operim si Qendër Rinore, në katin e parë të objektit të QR. "Naxhije dhe Fahri Buçinca" në Vushtri, në kohëzgjatje prej dy (2) vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, me mundësi të shfrytëzimit sipas nevojës edhe të dy sallave të qendrës.
2. Licenca do të revokohet para kalimit të afat të cekur në pikën paraprake të këtij vendimi, në rast të keqpërdorimit të licencimit nga OJQ "Hareja" respektivisht në rast të mosrespektimit të marrëveshjes për operim – shfrytëzim të hapësirave.
3. Të drejtat obligimet dhe përgjegjësitë për shfrytëzim të hapësirave për të cilat ipet licencimi do të rregullohen me marrëveshje të veçantë në mes të OJQ "Hareja" dhe Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Vushtri.
4. Vendimi hyn në ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi i dërgohet Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dhe OJQ "Hareja" në Vushtri, me qëllim të njoftimit dhe veprimit sipas të njëjtit.

A r s y e t i m

Organizata Joqeveritare "Hareja" në Vushtri ka aplikur për licencim si qendër rinore sipas thirrjes publike të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport dt. 19.10.2020. Komisioni i formuar për shqyrtim të kërkesave të OJQ-ve të cilat kanë aplikuar në këtë thirrje publike ka verifikuar të gjithë dokumentacionin e ofruar nga OJQ-të me rastin e aplikimit të tyre. Pas një analize të detajuar të kërkesave për aplikim dhe dokumentacionit të bashkëngjitur, bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike, komisioni ka vlerësuar se OJQ "Hareja" në Vushtri i

ka plotësuar të gjitha kushtet dhe kriteret që janë kërkuar nga komuna për licencim e që janë parapa me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore, andaj i ka rekomanduar kryetarit të komunës që të merr vendim me të cilin kësaj OJQ-je të i ipet e drejta për licencim të Qendrës Rinore “Naxhije dhe Fahri Buçinca” në Vushtri.

Nga se u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv.

KËSHILLIM JURIDIK: OJQ-të të cilat kanë aplikuar në thirrjen publike për licencim të Qendrës Rinore, mund të ushtrojnë ankesë kundër këtij vendimi, brenda 15 ditësh nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë. Ankesa i adresohet komisionit të ankesave përmes Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës